

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E QEVERISJES ELEKTRONIKE DHE INOVACIONIT
KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMITNr. D-1038/2 prot.Tiranë, më 02/02 2024

Lënda: Kthim përgjigje

Z. DORIAN MATLIJA ✓

QENDRA "RES PUBLICA"

Bulevardi "Gjergj Fishta", godina 24, hyrja 3, ap. 7,

Njësia Administrative nr. 7, Tiranë

I nderuar z. Matlija,

Pranë Bashkisë së Tiranës, bazuar në ligjin 119/2014 "Për të drejtën e Informimit" është paraqitur kërkesa juaj, e cila është protokolluar me nr. prot. D-1038, datë 19.01.2024 dhe ka kaluar për shqyrtim pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Menaxhimit Financiar, e cila nëpërmjet Drejtorisë së Buxhetit me shkresën me nr. D-1038/1, datë 30.01.2024 ka kthyer përgjigje si vijon:

"Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, ku keni kërkuar informacion në lidhje me programin "Tirana European Youth Capital", ju informojmë se:

Me VKB nr. 126, datë 15.10.2021 është miratuar draft marrëveshja e bashkëpunimit midis Bashkisë Tiranë dhe Kongresit Rinor Kombëtar si dhe manuali për menaxhimin e tij shoqëruar dhe me efekte financiare për vitin 2021 në vlerën 53,920,300 lekë.

Me VKB nr. 166, datë 24.12.2021 për "Miratimin e PBA 2022-2024 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2022 (i ndryshuar) si dhe me VKB Nr. 119 datë 15.11.2022 "Për ndryshimin e marrëveshjes së bashkëpunimit midis Bashkisë Tiranë dhe Kongresit Rinor Kombëtar" shoqëruar me efekte financiare, për vitin 2022 fondet e miratuara ishin në vlerën 367,987,018 lekë.

Në zbatim të VKM nr. 287, datë 29.04.2022 si dhe VKB Nr. 49 datë 14.06.2022, Bashkisë Tiranë ju akordua në buxhetin e vitit 2022 fondi i kushtëzuar në vlerën 700,000,000 lekë si mbështetje financiare e qeverisë në kuadër të titullit të fituar.

Me VKB nr.126, datë 23.12.2022 për "Miratimin e PBA 2023-2025 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2023 (i ndryshuar) buxheti i miratuar për të përmbyllur këtë projekt është në vlerën 100,000,000 lekë.

Bashkëlidhur shkresës po ju dërgojmë dhe një kopje të VKB-ve të cituara më lart.

Sa më sipër lutemi dijeninë tuaj.

Me respekt

KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT


Blerta Goxha



**BASHKIA
TIRANË**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 126, datë 15.10.2021

**“PËR
MIRATIMIN E DRAFTMARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT MIDIS BASHKISË
TIRANË DHE KONGRESIT KOMBËTAR RINOR “PËR FINANCIMIN DHE
ZBATIMIN E PROGRAMIT “TIRANA EUROPEAN YOUTH CAPITAL 2022” DHE
MANUALIT PËR MENAXHIMIN E TIJ, QË KANË PËR QËLLIM FINANCIMIN DHE
ZBATIMIN E PROGRAMIT “TIRANA EUROPEAN YOUTH CAPITAL 2022”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nënpikës 1.3, shkronja “a”, nenit 54, shkronja “k”, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 35, të ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001, “Për organizatat jofitimprurëse”, të ndryshuar, nenit 11, pika 5 dhe nenit 15, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 17/2019, “Për rininë”, Memorandumit të Mirëkuptimit nr. 31206 prot., datë 17.09.2020 lidhur ndërmjet Kongresit Rinor Kombëtar dhe Bashkisë Tiranë, Marrëveshjes së Bashkëpunimit nr. 14255 prot., datë 06.04.2021 lidhur ndërmjet European Youth Forum AISBL dhe Bashkisë Tiranë, shkresës nr. 35702 prot., datë 17.09.2021 të Kongresit Kombëtar të Rinisë, Memos nr. 39259 prot., datë 08.10.2021, me propozimin e kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:


1. Miratimin e draftmarrëveshjes së bashkëpunimit midis Bashkisë Tiranë dhe Kongresit Kombëtar Rinor “Për financimin dhe zbatimin e programit “Tirana European Youth Capital 2022”” dhe manualit për menaxhimin e tij, të cilat duhet të përmbajnë të paktën parashikimet, sipas teksteve që i bashkëlidhen dhe janë pjesë përbërëse të këtij vendimi dhe kanë për qëllim financimin dhe zbatimin e programit “Tirana European Youth Capital 2022”.
2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi do të përballohen nga fondi i përcaktuar për projektin “Tirana European Youth Capital 2022”, nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës, në artikullin 604, në Programin Sport dhe Argëtim/Rinore dhe Sportive.
3. Në zbatim të pikës 2, për vitin 2021, buxheti i planifikuar do të jetë sipas tabelës, Nr.1 bashkëlidhur pjesë përbërëse e këtij vendimi, duke reflektuar rishpërndarjen e fondeve në Programin e Sport Argëtim dhe Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile (Emergjencia Civile).
4. Ngarkohet kryetari i Bashkisë ose personi i autorizuar prej tij, për nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje, si dhe çdo akti tjetër të nevojshëm, në funksion të zbatimit të parashikimeve të pikës 1, të këtij vendimi.

5. Ngarkohen kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit, Drejtoria e Përgjithshme e Promovimit të Qytetit, Drejtoria e Përgjithshme e Integritetit, Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Agjencia e Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas parashikimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

K R Y E T A R

ROMINA KUKO



PASQYRA NR.1
RISHPERNDARJA E FONDEVE TE SHPENZIMEVE DHE INVESTIMEVE NDERMJET PROGRAMEVE BUXHETORE

Në lekë											
	Programi	Kap	Art	Kodi Institucionit	Njesia shpenzuese	Kodi Projektit	Emertimi i Projektit	Tipologji	Kosto e plote	Shtese 2021	Pakesim 2021
1							PROGRAMI SPORT DHE ARGETIMI		53,130,583	53,920,300	53,920,300
1							Aparati i Bashkise		-	53,920,300	-
1	08130	5	604	2101001	Aparati i Bashkise		Tirana European Youth Capital 2022	Te tjera	-	53,920,300	-
2							PROGRAMI MBROJTJA NGA ZJARRI DHE MBROJTJA CIVILE		53,130,583	-	53,920,300
2							Aparati i Bashkise (Emergjencia Civile)		53,130,583	-	53,920,300
1	03280	5	231	2101001	Aparati i Bashkise (Emergjencia Civile)	1011533	Fond per nderhyrje emergjencash	Te tjera	53,130,583		53,920,300



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 166, datë 24.12.2021

“PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2022-2024 DHE DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË TIRANË PËR VITIN 2022”

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpikat 1.1 shkronja “b”, pika 1.3 shkronja “c” nenit 41, pika 1, neni 54, shkronjat “ç” dhe “dh”, nenit 55, pikat 3 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr.7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; nenit 6, shkronjat “ç” dhe “d”, nenit 33, pika 1, nenit 39, pika 1, nenit 40, nenit 41, pika 1 dhe 3 të ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neneve 6, 15, 17 dhe 32, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar; nenit 2, shkronja “c” dhe nenit 5, shkronjat “a” dhe “d” të ligjit nr.10405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, pikës 17, të vendimit nr.165, datë 02.03.2016, të Këshillit të Ministrave “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil dhe të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar; udhëzimit nr.7 datë 26.02.2021, të ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2022-2024”, udhëzimit plotësues nr.20 datë 09.07.2021, të ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2022-2024”, me propozimin e kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1. Të miratojë Programin Buxhetor Afatmesëm të Bashkisë së Tiranës për periudhën 2022-2024 si më poshtë vijon:

1.1. Plani i të ardhurave të Bashkisë së Tiranës për periudhën 2022-2024, është në shumat si më poshtë:

Në lekë				
Lloji i të ardhurave	Plan 2021	Parashikimi 2022	Parashikimi 2023	Parashikimi 2024
Të ardhura të taksueshme	9,748,398,000	9,721,200,000	9,754,260,000	9,783,812,000
Të ardhura jo takimore	4,467,038,000	4,686,053,000	4,770,670,000	4,852,416,000
Total të ardhura	14,215,436,000	14,407,253,000	14,524,930,000	14,636,228,000
Transferta e pakushtezuar e përgjithshme	2,438,116,570	2,523,450,850	2,550,000,000	2,600,000,000
Transferta e pakushtezuar sektorale	2,331,955,992	1,289,437,150	1,300,000,000	1,350,000,000
Total Transferta	4,770,072,562	3,792,887,800	3,850,000,000	3,950,000,000
Të ardhura të mbartura	4,225,888,463	5,400,000,000	2,500,000,000	2,000,000,000
Të ardhura të planifikuara nga donatorët		8,823,261		
Totali	23,211,097,025	23,608,964,061	20,874,930,000	20,586,228,000

1.2. Plani i shpenzimeve të Bashkisë së Tiranës për periudhën 2022-2024, është në shumat si më poshtë:

Në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Shpenzime personeli	6,555,843,612	6,578,757,381	6,574,274,533	6,574,274,526
Shpenzime të tjera operative	8,446,992,375	7,248,592,850	6,863,917,468	7,431,412,499
Shpenzime kapitale	8,208,261,038	9,781,613,830	7,436,737,999	6,580,540,975
TOTALI	23,211,097,025	23,608,964,061	20,874,930,000	20,586,228,000

2. Të miratojë detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2022, si më poshtë:

2.1. Të miratojë planin e të ardhurave të Bashkisë së Tiranës sipas Pasqyrës nr.1, pjesë përbërëse të këtij vendimi.

2.2. Të miratojë numrin e përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë së Tiranës sipas pasqyrës nr.2 dhe nivelin e pagave për punonjësit e "Agjencisë së Shërbimeve Funerale", sipas lidhjes nr.19, pjesë përbërëse të këtij vendimi.

2.3. Të miratojë një numër prej 15 punonjësish të Aparatit të Bashkisë për arkivën me kontrata me kohëzgjatje të pacaktuar me pagë bruto 45,000 lekë/muaj.

2.4. Punonjësit e Task Forcës e ngritur sipas vendimit nr. 45, datë 06.07.2016 të Këshillit Bashkiak "Për ngritjen e task forcës për regjistrimin e asambleve të bashkëpronësisë dhe administratorëve të bashkëpronësisë", i ndryshuar, të funksionojnë dhe të ushtrojnë funksionin e tyre me kontrata me kohëzgjatje të pacaktuar.

2.5. Të miratojë pagesë në formë honorari për 30 persona në Agjencinë së Rinisë për një periudhë 6 mujore gjatë vitit 2022 në shumën 15,000 lekë/muaj.

2.6. Të miratojë detajimin e shpenzimeve të Bashkisë së Tiranës sipas pasqyrave nr.3, nr.3.1, nr.3.1.1 dhe nr.3.1.2, pjesë përbërëse të këtij vendimi.

2.7. Të miratojë planin e shpenzimeve kapitale sipas programeve në pasqyrën nr.4, pjesë përbërëse të këtij vendimi.

2.8. Ngarkohet Drejtoria e Buxhetit të kryejë avancim të fondeve mujore sipas realizimit të të ardhurave për vitin 2022.

3. Të miratojë Kalendarin e përgatitjes së PBA 2023-2025.

4. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Përgjithshme e Promovimit të Qytetit, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit Strategjik, Projekteve Strategjike dhe Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Përgjithshme për Marrëdhëniet me Publikun dhe Jashtë, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile, Drejtoria e Përgjithshme e Teknologjisë së Informacionit dhe të të Dhënave, Drejtoria e Përgjithshme e Medias dhe Komunikimit, si dhe institucionet në varësi të Bashkisë Tiranë, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2022.

KRYETAR

ROMINA KUKO

AKTIVITETET		Art.603/604	Art.6511	Art.606	Art.609	Totali shpenzimeve
08130:Sport dhe argëtim	081: Shërbimet rekreative dhe sportive	100,000,000	-	-	-	353,004,789
	Aparati i Bashkise	100,000,000	-	-	-	130,000,000
	Tirana Youth Capital 2022	100,000,000	-	-	-	100,000,000

V E N D I M

Nr. 119, datë 15.11.2022

“PËR

NDRYSHIMIN E

**MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT MIDIS BASHKISË TIRANË DHE
KONGRESIT KOMBËTAR RINOR “PËR FINANCIMIN DHE ZBATIMIN E
PROGRAMIT “TIRANA EUROPEAN YOUTH CAPITAL 2022” DHE MANUALIT
PËR MENAXHIMIN E TIJ, QË KANË PËR QËLLIM FINANCIMIN DHE
ZBATIMIN E PROGRAMIT “TIRANA EUROPEAN YOUTH CAPITAL 2022”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nënpikës 1.3, shkronja “a”, nenit 54, shkronja “k”, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 35, të ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001, “Për organizatat jofitimprurëse”, të ndryshuar, nenit 11, pika 5 dhe nenit 15, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 75/2019, “Për rininë”, Memorandumit të Mirëkuptimit nr. 31206 prot., datë 17.09.2020 lidhur ndërmjet Kongresit Rinor Kombëtar dhe Bashkisë Tiranë, Marrëveshjes së Bashkëpunimit nr. 14255 prot., datë 06.04.2021 lidhur ndërmjet European Youth Forum AISBL dhe Bashkisë Tiranë, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 126 datë 15.10.2021 “Për miratimin e draftmarrëveshjes së bashkëpunimit midis Bashkisë Tiranë dhe Kongresit Kombëtar Rinor “Për financimin dhe zbatimin e programit “Tirana European Youth Capital 2022”” dhe manualit për menaxhimin e tij”, shkresës nr. 138/4 prot., datë 11.11.2022, të Kongresit Rinor Kombëtar, memos me nr. prot. 40837, datë 14.11.2022 të Drejtorisë së Përgjithshme të Promovimit të Qytetit, me propozimin e kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Në marrëveshjen e bashkëpunimit midis Bashkisë Tiranë dhe Kongresit Kombëtar Rinor me nr. 41226/3 prot., datë 25.10.2021, “Për financimin dhe zbatimin e programit “Tirana European Youth Capital 2022”, miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 126 datë 15.10.2021 “Për miratimin e draftmarrëveshjes së bashkëpunimit midis Bashkisë Tiranë dhe Kongresit Kombëtar Rinor dhe manualit për menaxhimin e tij” bëhen disa ndryshime dhe shtesa sipas tekstit bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Efektet financiare që rrjedhin nga ndryshimi i marrëveshjes dhe manualit do të përballohen nga fondi i përcaktuar për programin “Tirana Youth Capital 2022”, nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës, në artikullin 604, në Programin Sport dhe Argëtim, sipas tabelës bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij vendimi.

3. Ngarkohet kryetari i Bashkisë ose personi i autorizuar prej tij për nënshkrimin e marrëveshjes së ndryshuar, që lidhen në funksion të zbatimit të parashikimeve të pikës 1, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit, Drejtoria e Përgjithshme e Promovimit të Qytetit, Drejtoria e Përgjithshme e Integritetit, Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit Ekonomik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas parashikimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

Z V / K R Y E T A R

VJOLLCA BRAHO

A handwritten signature in black ink, appearing to be 'Vjollca Braho', written over a circular official stamp. The signature is fluid and stylized, with a long horizontal stroke extending to the right.

Në lekë													
Nr	Prog.	Kap	Art	Kodi Inst	Njesia shpenzuese	Kodi Projektit	Emertimi i Projektit	Tipologji	Kosto e plote	Shtese 2022	Pakesim 2022	Shtese 2023	Pakesim 2023
							PROGRAMI SPORT DHE ARGETIM		293,886,933	267,987,018	267,987,018	67,272,060	67,272,060
1							Aparati i Bashklise		-	267,987,018	-	67,272,060	-
1.1									-		-		
1	8130	5	604	2101001	Aparati i Bashklisë		Tirana Youth Capital 2022	Shpenzime Operative		267,987,018		67,272,060	-
2							PROGRAMI STREHIMI LOKAL DHE URBANISTIKA		293,886,933	-	242,466,883	-	67,272,060
2.1							Aparati i Bashklise		293,886,933	-	242,466,883	-	67,272,060
1	6140	5	231	2101001	Aparati i Bashklisë	1011472	Shpronetime te tjera per interes publik	Shpronetime	109,092,185		217,890,333		32,591,416
2	6140	5	231	2101001	Aparati i Bashklise	1012103	"Rikualifikimi urban i bllokut qe kufizohet nga rruga e "Elbasanit" – "Stavri Vrinjao" – "Pjetër Budi" – "Ali Visha"	Shpronetime	184,794,748		24,576,550		24,680,634
3							PROGRAMI I SHERBIMEVE PUBLIKE VENDORE		-	-	26,620,136	-	-
3.1							Aparati i Bashklisë		-	-	26,620,136	-	-
1	6260	5	231	2101001	Aparati i Bashklisë	1011672	Investime te pa detajuara ne programin e sherbimit publik vendor	Te tjera	-		25,520,135		-

V E N D I M

Nr. 49, datë 14.06.2022

“PËR

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 166, DATË 24.12.2021, TË KËSHILLIT
BASHKIAK “PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2022-
2024 DHE DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË SË TIRANËS PËR VITIN
2022, TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpikat 1.1 shkronja “b”, pika 1.3 shkronja “c”, nenit 41, pika 1, nenit 54, shkronja “dh”, nenit 55, pikat 3 dhe 6 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, nenit 45 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenit 43 dhe nenit 44, të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, aktit normativ nr. 8, datë 7.12.2019 “Për përdorimin e procedurës së përshpejtuar për subvencionimin e pagesës së qirasë së banesës për familjet e mbetura të pastreha, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019”, të ndryshuar, udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, udhëzimit plotësues nr.1, datë 10.01.2022, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”, Ligjit Nr.79/2017 “Për Sportin” i ndryshuar; udhëzimit nr. 35 datë 21.09.2020 “Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare”, të ndryshuar, vendimit nr. 414, datë 08.07.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, vendimit nr. 287, datë 29.04.2022, të Këshillit të Ministrave “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2022, miratuar për Ministrinë e Kulturës, për Bashkinë Tiranë, për financimin e Projektit “Tirana Kryeqyteti Evropian i Rinisë 2022”, njoftimit me shkresë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me nr. prot. 1339/2, datë 10.05.2022 me lëndë “Mbi trashëgimin e fondeve për vitin 2022” për studim projektimin “Kampusi i Universitetit të Tiranës, Ndërtimi i Universitetit të Arteve dhe Ndërtimi i Akademisë së Policisë”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 789 datë 15.12.2021 “Për kriteret, mënyrën e shpërblimit dhe trajtimin e sportistëve që përfitojnë statusin e nivelit të lartë dhe trajnerëve të tyre”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

Në vendimin nr. 166, datë 24.12.2021, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2022-2024 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2022”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Miratimin e rishpërndarjes së fondeve të shpenzimeve korrente dhe kapitale ndërmjet programeve buxhetore sipas pasqyrës nr.1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Miratimin e shtesës së fondeve të kushtëzuara që i janë akorduar Bashkisë Tiranë, nga Qeverisja Qëndrore sipas pasqyrës nr.2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.

3. Përfshirjen në programin buxhetor afatmesëm të financimeve të huaja të akorduara si rezultat i projekteve të fituara në formën e grantit mes Bashkisë së Tiranës dhe Bashkimit Europian sipas pasqyrës nr.3, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.

4. Miratimin e detajimit të fondeve të akorduara nga donatorët gjatë vitit 2022, referuar marrëveshjeve të lidhura midis Bashkisë së Tiranës dhe donatorëve, sipas pasqyrës nr.3, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.

5. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Liçensimit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social, Drejtoria e Përgjithshme e Promovimit të Qytetit, Drejtoria e Përgjithshme e Integritetit, Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile, MZSH-ja, Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike si dhe Klubi Sportiv "Tirana" për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.



PASQYRA NR.2
 DETAJIM I FONDEVE TË KUSHTËZUARA TË AKORDUARA NGA QEVERISJA QËNDRORE PËR VITIN 2022

Në lekë

Entiteti Qeverises	Ministria e Linjes	Kodi Institucionit	Emri i Institucionit	Kap	Programi	Artikulli	Kodi i Projektit	Emërtimi i Projektit	Plan Buxheti viti 2022	Plan Buxheti viti 2023	Plan Buxheti viti 2024
101	11	2101001	Bashkia Tirane	1	9450	2310000	18BD509	Studim projektim "Kampusi i Universitetit të Tiranës", "Ndërtim i Universitetit të Arreve" dhe "Ndërtimi i Akademisë së Policisë"	500,000,000		
101	17	2101001	Bashkia Tirane	1	10910	6040000	91707AB	Fond Mbrojtja Civile/emergjenca civile	333,158,750		
101	12	2101001	Bashkia Tirane	1	8230	6040000	91203AO	Tirana,Kryeqyteti Europian i Rinisë 2022	700,000,000		

V E N D I M

Nr. 126 datë 23.12.2022

PËR
MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2023 - 2025 DHE
DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË TIRANË PËR VITIN 2023

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nën pikat 1.1 shkronja "b", pika 1.3 shkronja "c" nenit 41, pika 1, neni 54, shkronjat "ç" dhe "dh", nenit 55, pikat 3 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", ligjit nr.7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenit 6, shkronjat "ç" dhe "d", nenit 33, pika 1, nenit 39, pika 1, nenit 40, nenit 41, pika 1 dhe 3 të ligjit nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neneve 6, 15, 17 dhe 32, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, nenit 2, shkronja "c" dhe nenit 5, shkronjat "a" dhe "d" të ligjit nr.10405, datë 24.3.2011 "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", pikës 17, të vendimit nr.165, datë 02.03.2016, të Këshillit të Ministrave "Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", të ndryshuar, udhëzimit nr.8 datë 28.02.2022, të ministrit të Financave dhe Ekonomisë "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023 - 2025", udhëzimit plotësues nr.23 datë 08.07.2022, të ministrit të Financave dhe Ekonomisë "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023-2025", me propozimin e kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Të miratojë Programin Buxhetor Afatmesëm të Bashkisë së Tiranës për periudhën 2023 - 2025 si më poshtë vijon:

- 1.1. Plani i të ardhurave të Bashkisë së Tiranës për periudhën 2023 - 2025, është në shumat si më poshtë:

Në lekë

Lloji i të ardhurave	Plan 2022	Parashikimi 2023	Parashikimi 2024	Parashikimi 2025
Të ardhura të taksueshme	9,721,200,000	10,879,500,000	11,524,000,000	11,568,000,000
Të ardhura jo tatimore	4,686,053,000	5,554,000,000	5,607,000,000	5,662,000,000
Total të ardhura	14,407,253,000	16,433,500,000	17,131,000,000	17,230,000,000
Transferta e pakushtezuar e përgjithshme	2,523,450,650	3,008,634,292	3,008,634,292	3,118,503,000
Transferta e pakushtezuar sektoriale	1,269,437,150	1,324,954,914	1,324,954,914	1,324,954,914
Total Transferta	3,792,887,800	4,333,589,206	4,333,589,206	4,443,457,914
Të ardhura të mbartura	5,400,000,000	8,000,000,000	2,148,458,921	2,167,345,791
Të ardhura të planifikuara nga donatorët	8,823,261	5,787,444		
Totali	23,608,964,061	28,772,876,650	23,611,048,127	23,840,803,705

- 1.2. Plani i shpenzimeve të Bashkisë së Tiranës për periudhën 2023 - 2025, është në shumat si më poshtë:

Në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024	Plan 2025
Shpenzime personeli	6,578,757,381	7,535,487,444	7,529,700,000	7,529,700,000
Shpenzime te tjera operative	7,248,592,850	8,361,196,095	7,665,829,580	7,567,074,559
Shpenzime kapitale	9,781,613,830	12,876,193,111	8,415,518,547	8,744,029,146
TOTALI	23,608,964,061	28,772,876,650	23,611,048,127	23,840,803,705

2. Të miratojë detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2023, si më poshtë:

2.1. Të miratojë planin e të ardhurave të Bashkisë së Tiranës sipas Pasqyrës nr.1, pjesë përbërëse të këtij vendimi.

2.2. Të miratojë numrin e përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë së Tiranës sipas pasqyrës nr.2 pjesë përbërëse të këtij vendimi.

2.3. Të miratojë detajimin e shpenzimeve të Bashkisë së Tiranës sipas pasqyrave nr.3, nr.3.1, nr.3.1.1 dhe nr. 3.2 , pjesë përbërëse të këtij vendimi.

2.5. Të miratojë planin e shpenzimeve kapitale sipas programeve buxhetore sipas pasqyrës nr.4, pjesë përbërëse të këtij vendimi.

2.6. Ngarkohet Drejtoria e Buxhetit të kryejë avancim të fondeve mujore sipas realizimit të të ardhurave për vitin 2023.

3. Të miratojë Kalendarin e përgatitjes së PBA 2024 - 2026.

4. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Përgjithshme e Promovimit të Qytetit, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit Strategjik, Projekteve Strategjike dhe Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Përgjithshme e Mjedisit dhe Zhvillimit të Qendrueshëm, Drejtoria e Përgjithshme për Marrëdhëniet me Publikun dhe Jashtë, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile, Drejtoria e Përgjithshme e Teknologjisë së Informacionit dhe të të Dhënave, Drejtoria e Përgjithshme e Medias dhe Komunikimit, si dhe institucionet në varësi të Bashkisë Tiranë, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2023.

K R Y E T A R

ROMINA KUKOLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË



Pasqyra Nr.3.1.1
Planifikimi i Buxhetit të Njësisë Shpenzuese për vitin 2023

AKTIVITETET			Në lekë	
			Art.604	Totali Buxhetit
081: Shërbimet reкреative dhe sportive	08130: Sport dhe argëtim	Tirana Youth Capital 2022	100,000,000	100,000,000
			100,000,000	100,000,000



Res Publica <qendra.respublica@gmail.com>

238

05/8

Përgjigje nga Bashkia Tiranë

E Drejta Per Informim <edrejtaperinformim@tirana.al>

Wed, Apr 3, 2024 at 3:58 PM

To: "qendra.respublica@gmail.com" <qendra.respublica@gmail.com>

Cc: "info@idp.al" <info@idp.al>

Përshendetje,

Në vijim të shkresës suaj me nr. prot. 714/1, datë 21.03.2024, protokolluar pranë Bashkisë Tiranë me nr. prot. 12415, datë 25.03.2024 dhe shkresës fillestare me nr. prot. D-1038, datë 19.01.2024 ju informojmë se në vijim të kthim përgjigjesqë ju kemi kthyer si më poshtë:

“Në vijim të shkresës me nr. prot. D-1038/2, datë 02.02.2024 vënë në dispozicion nga Koordinatori për të Drejtën e Informimit, në vijim të përgjigjeve të ardhura nga strukturat, ju informojmë se është i gjithë informacionin që kanë në dispozicion strukturat e Bashkisë Tiranë. Ju bëjmë me dije se informacione më të detajuara në lidhje me kërkesat e tua të tjera mund të gjenden të link-u i Tirana European Youth Capital <https://tiranaeyc2022.al/?external=1#?external=1>, ose mund të drejtoheni zyra të Tirana European Youth Capital të cilat ndodhen në rrugën “Papa Kristo Negovani”, kompleksi “Moxart”, godina “Lim Em”, hyrja 1, kati 1”.

Gjithashtu ju informojmë se Drejtoria e Përgjithshme e Promovimit të Qytetit me shkresën me nr. prot.12415/1, datë 03.04.2024 informon se nuk disponon informacionin e kërkuar nga Qendra “Res Publica”.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin.

Ju urojmë ditë të mbarë

KOORDINATORE PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

**BASHKIA
TIRANË**

Bashkia Tiranë

Sheshi "SKËNDERBEJ",
Nd. 2, Kodi postar 1001,
Tiranë, Shqipëri

Web: www.tirana.al